



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr 46, datë 30.09.2025

**“MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR 6% PËR MUAJIN GUSHT 2025”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 30.09.2025, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga Grupi i Menaxhimit Strategjik, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 30/1 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” si dhe Udhezimit nr. 3, datë 17.02.2017 i ndryshuar, VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike. Udhëzimi nr. 10, datë 26.09.2006, si dhe VKM nr.8, datë 14.05.2015 “Për kompesimin e faturës së energjisë elektrike për heqjen e fashës deri në 300 KËH si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 2 datë 21.01.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”  
Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe PAK-së:

VENDOSI:

1. Mbi miratimin e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin Gusht 2025 përfitojnë **9 familje** me një fond prej **29 405 lekë** nga këto **6 familje** përfitojnë kompesimin e energjisë elektrike me fond **3840 lekë**.
2. Fondi gjithsej i shpenzuar për muajin Gusht 2025 është **33 245 lekë**.
3. Familjet përfituese sipas listës bashkëlidhur.
4. Nivelet e pagesës të jenë bazuar në V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, si dhe Udhezimit nr. 3, date 17.02.2017, i ndryshuar.

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

